



Veprimet e thjeshta mund të parandalojnë MAD

Murtaja afrikane e derrave (MAD) është sëmundje fatale për derrat. Përhapja e kësaj sëmundjeje në të gjithë globin shkakton humbje të mëdha në derra dhe pasoja të rënda socio-ekonomike. Industria e prodhimit të derrave ka risk për sigurinë ushqimore dhe jetesën e miliona njerëzve. **Ne të gjithë luajmë një rol të rëndësishëm për t'i mbrojtur ata.**

SI PËRHAPET MAD

SA MË SHUMË INFORMACION TË KEMI, AQ MË SHUMË MUND TË KONTRIBUOJMË NË PËRHAPJEN E SËMUNDJES

SHËNDETI juaj nuk është i kërcënuar nga MAD

Njerëzit nuk sëmuren nga MAD. Sëmundja nuk mund të transmetohet tek njerëzit përmes kontaktit me derrat ose duke konsumuar produkte me origjinë shtazore nga kafshët e llojit derra.




Ju mund të bëheni BARTËS i virusit të MAD

Virusi MAD-vë është shumë rezistent. Ju mund ta mbartni atë në veshje, këpucë, pajisje dhe automjete nëse keni vizituar një zonë të infektuar ose nëse ju merrni, sillni produkte me origjinë shtazore nga kafshët e llojit derra apo produkte me mish derri.



Ju mund të **NDIHMONI** në parandalimin e përhapjes së sëmundjes së MAD



- Shmangni transportin e produkteve me origjinë shtazore nga kafshët e llojit derra kur udhëtoni ose i deklaroni ato tek autoritetet përkatëse
- Qëndroni larg fermave të derrave dhe derrave të egër, përveç rasteve kur është e domosdoshme
- Mos i ushqeni derrat me mbeturina ushqimore ose mbetje të kuzhinës që përmbajnë produkte mishi
- Hidhni mbeturinat ushqimore që përmbajnë produkte me origjinë shtazore nga kafshët e llojit derra në konteiner të sigurt
- Raportoni rastet e derrave të sëmurë ose të ngordhur duke përfshirë edhe derrat e egër tek veterineri privat/zyrtar ose shërbimi veterinar më i afërt.